



UNIVERSITETI “KADRI ZEKA” UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: E Drejta e Procedurës Civile- Pjesa e posaçme

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta e Procedurës Civile(Pjesa e posaçme)
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i IV -të, semestri i VIII-të
Numri i orëve në javë:	3 +2
Vlera në kredi – ECTS:	8
Koha / lokacioni:	Ligjërata: (L); Salla:
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.ass. Muharrem Faiku
Ushtrime	Ass. Detrina Alishani
Detajet kontaktuese:	Muharrem.faiku@uni-prizren.com Detrina.alishani@uni-gjilan.net
Përshkrimi i lëndës	Lënda “E drejta procedurale civile” , pjesa e posaçme ka të bëjë kryesisht me të drejtën procedurale jokontestimore dhe përmbartimore dhe atë me fillimin, zhvillimin dhe përfundimin e ketyre procedurave. Në këtë lëndë do të trajtohen edhe çështjet e procedurës sipas mjeteve të goditjes së vendimeve.
Qëllimet e lëndës:	Me këtë lëndë tentohen të arrihen njohuritë bazë dhe të domosdoshme për realizimin faktik të një të drejte subjektive private, të konstatuar në procedurën civile dhe për të ashtuquajturën gjyqësinë vullnetare, pra procedurën jokontestimore.
Rezultatet e pritura të nxënies:	- Studenti do të jetë në gjendje që të kuptojë drejtë, se si realizohet faktikisht një e drejtë subjektive private nëpërmjet procedurës së përmbartimit; - Studenti do të jetë në gjendje që të kuptojë sistemin e ri të përmbartimit në Kosovë; - Studenti do të merr njohuritë bazë dhe të domosdoshme për procedurën jokontestimore si procedurë vullnetare!
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të	

studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	30	30
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime ne teren	1	2	2
Kolokviume	2	13	26
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	3	1	3
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	10	1	10
Totali	7 ECTS	Total	210
Metodologjia e mësimdhënies:	Koncepti didaktik do të jetë i tillë interaktiv në shqyrtimin e instituteve qendrore juridike për këtë lëndë. Kjo lëndë është shumë voluminoze dhe kështu do të shqyrtohen aspektet bazë të procedurës përmbartimore dhe jokontestimore dhe atë më shumë në aspektin teorik. Do të ofrohen disa raste për të trajtuar disa institute qendrore juridike të procedurës jonkontestimore dhe përmbartimore.		
Metodat e vlerësimit:	Kriteret e vlerësimit - Vijimi i rregullt dhe angazhimi në ligjërata dhe ushtrime - Do të ofrohet mundësia e prezantimit të një punimi seminarik - Testi kryesor (Kollokfiumi - Testi është mundësi dhe e drejtë dhe jo detyrim i kandidatit Nota do të ndërtohet në bazë të testit kryesor, seminarit dhe vijimit të rregullt. Nota e arritur në bazë të testit kryesor, seminarit dhe vijimit të rregullt Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10 Kalueshmëria e testit përfundimtar fillon nga 50 pikë e më lartë.		
Literatura			
Literatura bazë:	- Brestovci, Faik, E drejta procedurale civile II, Prishtinë 2004		

	Ligjet: Ligji për procedurën kontestimore Ligji për procedurën përmbarimore Ligji për procedurën jokontestimore Ligji për gjykatat -
Literatura shtesë:	Literaturë shtesë do përdoren ligjet pozitive në Republikën e Kosovës: - Morina, Iset/Nikqi, Selim, LPK-Komentar, Prishtinë, 2012 - Ligji Nr. 2004/32 për Familjen, - Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, - Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgiminë e Kosovës. - Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në të drejtën e procedurës përmbarimore Zhvillimet aktuale në të drejtën e procedurës përmbarimore
Java e dytë:	Bazat e së drejtës së procedurës përmbarimore
Java e tretë:	Parimet e së drejtës së procedurës përmbarimore - Subjektet e procedurës përmbarimore
Java e katërt:	Fillimi i procedurës së përmbarimit - Dokumenti përmbarimor
Java e pestë:	Kërkesa dhe baza për caktimin e përmbarimit
Java e gjashtë:	Mjetet e goditjes së vendimit në procedurën e përmbarimit
Java e shtatë:	Test ushtrues dhe provues
Java e tetë:	Zbatimi i aktvendimit/urdhrit
Java e nëntë:	Procedura sigurorese
Java e dhjetë:	Hyrje dhe parimet e së drejtës procedurale jokontestimore
Java e njëmbëdhjetë:	Procedurat jokontestimore statusore I
Java e dymbëdhjetë:	Procedurat jokontestimore statusore II
Java e trembëdhjetë:	Procedurat jokontestimore pasurore I
Java e katërbëdhjetë:	Testi i dytë (2)
Java e pesëmbëdhjetë:	Provimi përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshme dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore,
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore,

- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e kartelës në teste dhe provim,
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimmshënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit